

Pele: Çdo ndeshje futbollit e shikoj me sinqeritetin e një fëmije

Më 23 tetor të vitit 1940, Tres Coracoes, fshat i vogël ky në shtetin braziljan të quajtur Minas Gerais, nuk e festoi fare ditëlindjen e djalit të futbollistit Joao Romos do Nascimento, ose Dondinho, po të përdorim emrin me të cilin ai njihet në botën e futbollit. As Dondinho as Celeste (prindërit e Peles) nuk e dinin se në atë ditë tetori ata i dhanë jetë futbollistit më të mirë që ka njohur bota deri në ditët e sotme. Për ta do të ishte më pak e vështirë të mendonin se djali i tyre një ditë do të ishte një lustrues këpucësh i shkëlqyer. Sepse, në fakt, Lustrues këpucësh ka qenë puna e parë e Peles (Edson Arantes do Nascimento). Por ajo punë nuk do të zgjaste shumë për yllin e futbollit botëror. Sepse tek luante me disa nga skuadrat amatore si Baquinho, Sete Setembro dhe Ameriquinha, ish lojtari i mirënjohur braziljan Waldemar de Brito zbuloi Pelen, 11-vjeçar, që pas fare pak vitesh do të fillonte të ngrinte peshë zemrat e tifozëve të futbollit në të gjithë botën.

Intervistën me Pelen e zhvillova në Teksas, gjatë vizitës së tij zyrtare në prag të Kampionatit Botëror të futbollit '94.

Pyetje: Ç'ndryshime emocionale shikoni tek vetja, nga koha kur ishit duke hyrë tek ëndrra futbollistike, duke e përjetuar atë dhe tani që jeni në të dalë prej saj?

Pele: Ju e thatë në një mënyrë të re për mua. Po. Është e vërtetë se unë e kam kërkuar disi me ngut gjendjen tek ëndrra futbollistike si dhe përjetimin e saj. Po kaq e vërtetë është se jam duke dalë prej saj. Ajo që akoma nuk më besohet është pikërisht largimi fizikisht nga fusha e futbollit. Në këtë aspekt do të dëshiroja që koha të më trajtonte më mirë. Kohës, asnjëherë nuk ia kam pëlqyer bërërylet e saj të mërzhitshme, atë forcën shtytëse, atë plakjen graduale që të jep... Megjithatë, koha - kjo gjyqtare e drejtë pa flamuj e bilbile arbitrimi, më bindi se isha dhe mbetem një njeri i zakonshëm në shumë kuptime. Ajo po ashtu më bindi se, fare mirë, i duhej lëshuar vendi në fushë një ëndërrimtarit të ri, ashtu siç ma patën lëshuar vendin edhe mua idhujt e mi të futbollit Braziljan.

Pyetje: Po të pyesësh njerëzit e zakonshëm, tifozët e tu, shumë prej tyre do të dëshironin të kenë të paktën një ditë nga ditët tuaja. Si do e përshkruanit ju jetën e tuaj?

Pele: Kam kaluar një jetë të bukur, nisur nga ato që kam kërkuar prej saj. Eksperiencia që kam patur si futbollist është e papërsëritshme. Shpesh kam fjetur në divan me një top futbollit në vend të jastëkut, kur isha fëmijë, dhe jam zgjuar me lehtësinë shpirtërore më të madhe. Shpesh e kam ndier veten se jetoj në një univers të ndërthurur veçanërisht për mua. Por, nga ana tjetër, jeta

ime e deritanishme i ka ngjarë edhe një orteuku, i cili formohet nga zeroja me dëshirën për t'u rritur, duke shkatërruar shumë gjëra që i dalin përpara. E kam fjalën për ato gjëra të bukura që shijon një fëmijë apo një njeri i zakonshëm. Pra sakrificat që kam bërë që të jem plotësisht në shërbim të formimit tim si futbollist, natyrisht, e ka bërë të vetën kur është fjala për qejfet personale, përveç atyre që të sjell jeta e sportit. Sot, gjendem i ndaluar, si orteuku që thashë më lart, në fund të rotullimit ku gjatë shkrijes do të dalin më dukshëm në pah ato që kam thyer dhe marrë me vete gjatë jetës sime të deritanishme, e cila gjithmonë ka qenë në rotullim e sipër.


Pyetje: Janë krejtësisht të besueshme ato që thonë. Them kësh-tu duke pasur në mendje fillimet e jetës suaj si lustrues këpucësh. Domethënë, ju keni kaluar nga njëri ekstrem te tjetri. Ky mendim më çon të një pyetje tjetër, të cilën nuk e kam në listën e pyetjeve që kisha përgatitur t'ju bëja. Kur ktheni sytë nga fëmijëria çfarë sjell imazhi i saj tej ju?

Pele: Në atë kohë ndoshta do të kisha kërkuar edhe më shumë prej fëmijërisë. Ngaqë fëmijët nuk ngopen kurrë me lodra, lojra, vizita turistike etj. Por sot, sot nuk do të ndryshoja asgjë. Bukuria e fëmijërisë sime qëndron te surprizat dhe njohja e jetës së vërtetë. Jam shumë i lumtur që nuk jam rritur si "çun mamaje".

Pyetje: Nëse dikush do ta meritonte epitetin "Pele i dytë" kujt do t'ia pagëzonit pa derte këtë epitet?

Pele: Çdo ndeshje futbollit që shikoj, e shikoj me sinqeritetin e një fëmije. Shpesh herë gjej futbollistë si Maradona e Bebeto, të cilët së bashku me topin lëvizin edhe çehren e fytyrës sime, më tërheqin dhe më shtynjë sa tek njëra portë tek tjetra emocionalisht. Nga ky këndvështrim shoh që futbollit është ai qiell në bukurinë e të cilit yjet janë artplot me botën e tyre individuale, pa qenë nevoja t'i krahasojmë me njëri-tjetrin. Që të dal direkt te pyetja juaj, për mendimin tim, nuk do të ketë kurrë një Pele të dytë; mund të jenë më të mirë apo më të bobët, por jo një "Pele"...

Pyetje: Kampionati Botëror i Futbollit '94 do të fillojë



Pele

konkurencën javën që vjen. Kush mendon se do e fitojë atë këtë herë?

Pele: Sikur ta dija do të ishte një gjë e mirë. Megjithatë ua kam frikën befasisive. Skuadrat Evropiane gjithmonë bien gjëra sa të bukura aq edhe tronditëse (disomos për ne tifozët braziljanë) në takime të rëndësishme siç është Kupa Botërore e Futbollit. Po të ma bëje pyetjen se kush do të dëshiroja të fitonte, natyrisht, do të përgjigjesha që dëshiroj të fitojë Brazili. Porse kush do të fitojë... Megjithatë, shpresoj të shohim një ekip që do e meritojë vërtet Kupën e Artë nga të gjitha pikëpamjet. Më pëlqen shumë pastërtia në futboll.

Pyetje: Pothuajse të gjithë sportdashësit shqiptarë dinë diçka për ecurine tuaj në jetën e sportit. Po ju, a dini diçka për Shqipërinë dhe shqiptarët?

Pele: Duhej të dija më shumë. Megjithatë, njoh Nënë Terezën, të cilën e admiroj shumë. Po ashtu kam lexuar diçka edhe nga Kadareja. Për sa i përket futbollit shqiptar, do të thoja se ka mundësi më të mira tani pas rënies së komunizmit. Nuk duhet harruar, ama, se niveli ekonomik i një vendi ka të bëjë direkt me nivelin e sportit të tyre. Shqipëria akoma nuk e ka marrë veten si duhet. Kështu në një të ardhme të shkurtër, shpresoj se edhe futbollit shqiptar do të jetë i nivelit European.

Personalitete të politikës, artit dhe sportit në intervistimin e Gjekë Marinajt

Doli nga shtypi libri i ri me intervista të Gjekë Marinaj. Që nga Pele i madh i futbollit, ish presidenti Bush, princi i letrave shqipe Kadare, të gjithë vijnë në intervistimet e Gjekë Marinajt...

Gjekë Marinaj ka vite që punon për një libër me intervista. Pas gati 10 vjet punë e mundim libri ka marrë rrugën drejt lexuesit. Këto ditë munda i tij u kurorëzua me daljen e librit nga shtypi.

-M'u desh që një pjesë të intervistave t'i sakrifikoja për të respektuar lexuesin. Kam hequr më shumë se gjysmën e materialit të intervistuar - u shpreh ai për Illyria-n.

Po cilët janë personazhet që intervistohen nga Marinaj?

Janë njerëz të shquar, por nuk mungojnë edhe të thjeshtët, njerëz të zakonshëm që për lexuesin vijnë me karakteret e tyre, me botën e tyre shpirtërore; shpalosin përpjekjet e tyre në shërbim të qytetarëve të tyre dhe njerëzimit në tërësi, motivet që i kanë udhëhequr e i udhëheqin në jetë. Që nga Pele i madh, ish presidenti George Bush, Ismail Kadare e Dritëro Agolli, sjellin befasi për lexuesin. Nga bota e futbollit vijnë edhe yje të futbollit shqiptar, të cilët Gjeka i ka patur mysafir në Texas si: Vokri, Demollari, Majaci, Bruno Ceka e të tjerë. Janë dhe disa prej politikëveve shqiptar të intervistuar nga Gjeka siç janë edhe disa prej kolegëve të vet, poetë e shkrimtarë. Shumë prej



personazheve të librit janë intervistuar në kontakte të drejtëpërdrejta, por ka dhe raste, kur është përdorur posta elektronike, megjithatë lexuesi, sapo t'u bjerë në dorë libri, nuk do të arrijnë që të kuptojnë ndryshimin, sepse intimiteti i krijuar i ka fshirë kufijtë e largësisë.

Këtë radhë, me lejen e autorit po i paraqesim lexuesit një nga të intervistuarit VIP-Pelen e madhe të Brazilit. E kush gazetar nuk do ta kishte ëndërr një intervistë me Pelen!

Le ta urojmë poetin, studiuesin dhe publicistin Gjekë Marinaj.

Restorant në shitje

Shitet një restorant në lagje të Manhattan-it.

I hapur para 23 vitesh.

I njohur për kuzhinë italiane.

Ka 70 vende, bar dhe kuzhinë të përsosur.

Çmimi I volitshëm.

Për më shumë informata lajmërohuni në këtë numër telefoni:

718-584-9928 ose

917-494-1115

INTERNATIONAL DRIVER'S LICENSE

THIS IS TRANSLATION OF YOUR FOREIGN DRIVER'S LICENSE ISSUED BY INTERNATIONAL TOURIST CLUB

TEL/FAX: 718-232-1223

SPECIAL PRICES FOR AGENTS If you'd like to get International Driving Permit or non-government ID card, you should provide the following:

1. Copy of foreign driver's license
2. One passport size picture.
3. Last name, first name;
4. Date of birth MM/DD/YY

5. Country of birth;
6. Height;
7. Color of eyes;
8. Signature;

INTERNATIONAL TOURIST CLUB

INTERNATIONAL DRIVING PERMIT
INTERNATIONAL TOURIST CLUB

MEMBER CARD
TIC 18080010

NAME: LOYRE DA SILVA
GIVEN NAME: LOYRE
SURNAME: SILVA
Country of Birth: País sem Fronteiras
Date of Birth: 18 01 1968
Date of Issuance: 18 01 1998

New York State

IDENTIFICATION ONLY
000-0001
EXPIRES 10-23-03

ANGELA JOHNSON
123 MAIN ST
BROOKLYN 11219
NEW YORK

BIRTH: 05-01-1970 SEX: F
EYES: BRN HAIR: BRN

Department of the Treasury
Internal Revenue Service

999-99-9999
This number has been allocated to
CHICON CALIFORNE
to be used for tax purposes only

TAX ID NUMBER

\$35

6408 14 AVE BROOKLYN, NY 11219

Office hours: www.itconline.info

Mon-Fri 10am - 7pm

Sat-Sun 10am - 4pm

SUBWAY TRAINS:
W, M TO 62 ST
N TO NEW UTRECHT AVE